



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica– Municipality of Mitrovica North

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke u bazuar në nenin 78 paragrafi 2, nenin 80, 81 dhe 82 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 6 dhe nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr. 30/2024 për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, si dhe në bazë të kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë, shpallë:

K O N K U R S
PËR PRANIM NË MARRËDHËNIE PUNE
(Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar)

Institucioni: Komuna e Mitrovicës së Veriut

Drejtoria: Drejtoria e Shëndetësisë – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Titulli i vendit të punës: Infermier/e

Vendi i punës: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Numri i Pozitave: Dy (2);

Kategoria: Nëpunës i Shërbimit Publik;

Klasa e pagës: H17 – Koeficienti 5.4

Periudha e Kontratës: Në kohë të pacaktuar

Kohëzgjatja e punës provuese: Gjashtë (6) muaj për nëpunësen/in e shërbimit publik me kontratë me periudhë të pacaktuar.

Data e Njoftimit: 16.07.2025

Afati për aplikim: 17.07.2025– 16.08.2025

1. Qëllimi i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasior, bazuar në nivelin profesional që kërkohet për të gjithë profesionistët shëndetësor.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Praktikon përputhjen me kodin etik dhe zbaton procesin e kujdesit infermior;
- Komunikon dhe mban raporte të mira me kolegët dhe rezidentët;
- Kujdeset për Mirëqenien e rezidentëve dhe mirëmbajtjen e ambientit të punës;
- Bën përcjelljen, marrjen e masave preventive për ruajtjen e shëndetit të rezidentëve;
- Dhënia e terapisë sipas udhëzimeve të mjekut;
- Kujdesi hixhienik i rezidentëve dhe materialit medicinal;
- Informimi dhe përcjellja e rezidentit për trajtim të nevojshëm mjekësorë;

- h. Kujdesi për Shëndetin dhe terapinë e rezidentëve;
- i. Marrja e masave mbrojtëse epidemiologjike – hixhienike kundër infeksionit dhe dekuibitit të rezidentëve;
- j. Puna okupuese dhe aktivitetet me rezidentë;

3. Kriteret e Përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publik:

- a. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- b. Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- c. Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- d. Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- f. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- g. Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me këtë ligj.

4. Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- a. Bachelor (BSc), Infermieri;
- b. Licenca e punës lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë apo Oda e Infermierëve të Kosovës;
- c. Shkathtësi profesionale të përdorimit të aparaturave laboratorike;
- d. Aftësi për zbatim të vazhdueshëm të detyrave të punës sipas PVP;
- e. Përkushtim për ngritjen profesionale dhe përkushtim të kompetencave;
- f. Respektimi i konfidencialitetit 100% të kohës;
- g. Ndjenjë përgjegjësie dhe përkushtimi ndaj profesionit dhe ndryshimeve;
- h. Shkathtësi të mira të komunikimit;
- i. Shkathtësi pune si i pavarur dhe në ekip;
- j. Njohuri të punës me kompjuter;
- k. Gatishmëri të punoj me të gjitha grupet, pa dallim: kulture, besimi, race, ngjyre, gjinie, moshe, statusi social, apo vlera të përceptuara ekonomike;

5. Mënyra e aplikimit:

- a. Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund ti marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, apo ti shkarkojnë nga web-faqja zyrtare e Komunës së Mitrovicës së Veriut <https://mitroviceeveriut.rks-gov.net/> dhe portali shtetëror i konkurseve për punësim <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe të plotësuara ti dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në Komunën e Mitrovicës së Veriut nga ora 08:30 deri në ora 15:00, çdo ditë pune.

6. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- a. Formulari i aplikimit, i plotësuar;
- b. Kopjet e dokumentit personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- c. Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar (*prezantohet nga kandidati nëse ai/ajo përzgjidhet për emërim pas përfundimit të vlerësimit dhe në përputhje me rezultatin e arritur*);

- d. Dëshmi mjekësore se kandidati është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse (*prezantohet nëse kandidati përzgjidhet për emërim*);
- e. Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj);
- f. Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore (personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit);
- g. Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- h. Kopjen e licencës.

7. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

- a. Testimi me shkrim (deri në 70 pikë);
- b. Intervista me gojë (deri në 30 pikë).

8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:

- a. Përmes web-faqes zyrtare të Komunës së Mitrovicës së Veriut (<https://mitroviceeveriut.rks-gov.net/>) dhe portali shtetëror i konkurseve për punësim (<https://konkursi.rks-gov.net/>) postës elektronike ose numrit të deklaruar në aplikacion.

9. Sqarime shtesë:

- a. Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.
- b. Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).
- c. Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit.
- d. Deklarimi i rrejshëm paraqet shkas për përjashtim nga procedura e rekrutimit.
- e. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.
- f. Nëse kandidatët aplikojnë në dy e më tepër vende të punës, kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione të veçanta për secilin vend të punës.
- g. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional siç specifikohet me legjislacionin në fuqi.